



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT NË MES TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE DHE MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

28.07.2009

Në lokale e Ministrisë së Punëve të Brendshme, sot në ora 11.30 minuta, është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në mes të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe, Ministrisë së Punëve të Brendshme. Memorandumi, ka të bëjë me bashkpunimin dhe përgjegjësitë që dalin nga të dy këto institucione, lidhur me Listën Votuese të zgjedhjeve të 15 Nëntorit. Nënshkrimi i Memorandumit, është bërë nga Kryetarja e KQZ-së, Nesrin Lushta dhe, Ministri i MPB-së, z. Zenun Pajaziti. Në takim, kanë qenë të pranishëm Drejtori i Policisë së Kosovës, z. Sheremet Ahmeti, Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani etj.